



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE MALLRAVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për operatorin ekonomik : **Advanced Bussines Solutions (ABS)“ sh.p.k**

Procedura e prokurimit:Kërkesë për Propozime -Shërbime

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-02837-12-31-2018,Nr.REF Loti 1 REF-02839-12-31-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Mirembajtje sistem biletarie si dhe mirembajtje dhome serveri i ndare ne lote" Loti 1”Mirëmbajtje Dhomë Serveri me fond limit 2,999,900(dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind)lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- **Advanced Bussines Solutions (ABS)“ sh.p.k** K21710002J
Emri i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera 2.779.200 (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

- **“Xpert System ”sh.p.k** L51511023L
Emri i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera 2 394 000 (dy million e treqind e nentëdhjete e kater mije leke) pa tvsh.

- **“Tetra Solutions” sh.p.k** K72017027P
Emri i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera 0(zero)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Xpert System ”sh.p.k

L51511023L

Emri i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 2 394 000 (dy million e treqind e nentëdhjetë e kater mijë leke) pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2 si më poshtë cituar:

1.Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve (2016,2017), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik KVO vëren se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar në pikën 2.2 cka bie në kundërshtim me kushtin e kërkuar në DST.

Theksojmë se kriteri i kërkuar në DST ka qënë i qartë dhe nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit nga ana e tyre.

Nëse ju do të kishit paqartësi mbi vendosjen e kriterit të sipërpërmendur mbi vendosjen e kriterëve keni pasur momentin procedural të parashikuar në nenin 42 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik në të cilën shprehimisht citohet se....

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.

Evidentimi i mungesës së dokumentacionit të kërkuar në DST KVO konkludon se operatori nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe **paraqesin te plote te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne DT .**

Moplotësimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim .

Në shtojcën 7 shprehimisht parashikohet se.... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Së dyti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika si më poshtë cituar:

2.8.Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Qershor 2018-Nëntor 2018.**

Në vazhdim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik KVO konstatoi se operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar në pikën 2,8 të kushteve të DST. Përsa më sipër dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik do të konsiderohet I paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit 2.1.d si më poshtë vijon:

d. Deklaraten mbi përmbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 5

KVO vëren se operatori ekonomik ka paraqitur në sistemin elektronik deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike (shtojca 5).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit për këtë pike K.V.O konstaton se deklaratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk janë sipas formatit të hartuar e miratuar nga A.P.P ,si dhe DST të publikuar në sistemin elektronik për këtë procedurë prokurimi të shpallur nga AK.

KVO , gjykon se, “**Xpert SYSTEM**” shpk , nuk ka paraqitur dokumentacion sipas setit të DST që APP ka publikuar në www.app.gov.al dhe që janë detyruara për zbatim nga cdo AK në procedurat e vitit 2018 e në vijim .

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nen 41, pika 1, ku parashikohet se: “*Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike*”, si edhe Seksionit II “*Udhëzime për operatorët ekonomikë*”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme*”.

KVO vlereson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori “**Xpert SYSTEM**” shpk nuk është i saktë dhe sipas dokumentave të cilat janë aktualisht në fuqi.

Dokumentet e tenderit, janë dokumenta, që autoriteti kontraktor ia vë në dispozicion kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave. Në hartimin e këtyre dokumenteve, autoriteti kontraktor duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit e si rrjedhojë edhe operatorët ekonomikë duhet të përdorin këto dokumenta.

Rrjedhimisht, që nga data kur ka hyrë në fuqi e është publikura vendimi I APP për miratimin e DST për vitin 2018, të gjitha procedurat e prokurimit do të shpallen nga autoritetet kontraktore sipas setit të dokumentave standarde të tenderit, të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe rrjedhimisht, operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë të detyruar të plotësojnë këto dokumenta. KVO konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar.

Prandaj , **Xpert SYSTEM** shpk duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Neni 53/2 I LPP përcakton qartë se , nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Rrjedhimisht, gjykojmë se, ky dokument nuk përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për atë çka shërben dhe është i destinuar, duke mos qenë në përputhje me LPP dhe RrPP.

Referuar sa më sipër, KVO konkludon se, dokumentacioni i paraqitur nga “**Xpert SYSTEM**” sh.p.k nuk është sipas dokumentave standarde të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “*Prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu

VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

2. “Tetra Solutions” sh.p.k

K72017027P

Emri i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 0(zero)

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Tetra Solutions” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Tetra Solutions” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 8, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të **nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Advanced Bussines Solutions (ABS)” sh.p.k se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2.779.200 (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë UKT sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **17.01.2019**

Ankesa:JO

